



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkiv: Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive

Nr./Br.No. 1282/2
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 1+11
Data/Datum/Date: 30.03.2023
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Datë: 30.03.2023

Ref. KM-119/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10, 11 dhe nenin 30 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.7/ 01 mars 2019), nenin 9 të Rregullores (QRK)-NR.3/2020 për Përfomancën e Agjencive, dhe nenin 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4, nenin 15 Shtojcën 11 të Rregullores (QRK)-NR.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

V E N D I M



1. Miratohet Plani i Përfomancës për Agjencinë për Ushqim dhe Veterinarisë për vitin 2023 në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Faton PEÇI
Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Vendimi i dërgohet:


- Kabinetit të Ministrit,
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
- Agjencisë për Ushqim dhe Veterinarisë,
- Zyrës së Kryeministrit, dhe
- Arkivit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë/ Agencija za Hranu i Veterinarstvo/Food and Veterinary Agency

DATË/A:	29.03.2023
REFERENCË:	AUV. 01-135/2023
PËR/ZA/TO:	Faton Peci, Ministër ne MBPZHR
CC:	Blerim Hasani, Sekretar i Përgjithshëm i MBPZHR Hysen Muzliukaj, Këshilltar Politik ne MBPZHR; Flutra Mustafa, Shefe e Kabinetit te Ministrit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Flamur Kadriu, Zv. Drejtor Ekzekutiv i AUV 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i Performances për Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari për vitin 2023

I nderuari z. Ministër,

Në mbështetje të nenit 30 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr.7/ 01 mars 2019), nenin 9 të Rregullores (QRK)-NR.3/2020 për Përformancën e Agjencive të datës 18.02.2020, duke u bazuar ne kompetencat ligjore të shqyrtoni dhe miratoni Planin e Përformancës për Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari për vitin 2023.

Bashkangjitur e gjeni:

- *Planin e Përformancës për Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari për vitin 2023,*

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural /Ministarstvo Poljoprivrede Sumarstva i
Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture Forestry and Rural Development

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY

PLANI I PERFORMANCËS
AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
2023

Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është agjenci ekzekutive e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe është e organizuar në pajtim me Rregulloren Nr. 03/2010 për Organizimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Fushëveprimi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë përfshin çështjen e sigurisë së ushqimit, me prejardhje shtazore dhe bimore, çështjen e shëndetit publik, shëndetit të kafshëve dhe të mirëqenies së tyre, shëndetin e bimëve si kontrollet zyrtare nga fushat e veterinarisë, fitosanitarisë dhe sanitarisë.

Sistemi i sigurisë ushqimore ka për qëllim të vendosë bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesat e konsumatorit, ky sistem zbatohet në të gjitha fazat e prodhimit primar dhe në të gjitha fazat e trajtimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve të njerëzve dhe ushqimeve për kafshë.

Planin e Përformancës për vitin 2023, AUV e ka përgatitur duke marrë parasysh prioritetet e saj dhe duke u bazuar në buxhetin, burimet njerëzore dhe teknike, që ka në dispozicion për vitin vijues.

Me objektivin e parë, që është mbrojtja e shëndetit publik, AUV bazuar në Ligjin për Ushqimin Nr. 08/L-120 , Ligjin e Veterinës Nr. 21/2004 dhe aktet nënligjore në fuqi, përmes Drejtorisë së Shëndetit Publik edhe gjatë vitit 2023 do të vazhdon me trajtimin e problematikes së mbrojtjes së shëndetit publik, sigurisë ushqimore, mbetjeve në ushqim dhe nënprodukteve shtazore.

Objektiva e dytë parashikon kontrollin e subjekteve veterinarë dhe fermave blegtorale me qëllim të monitorimit mbi aplikimin e barnave veterinarë, lajmërimin e sëmundjeve, përkujdesen ndaj kafshëve, identifikimin, regjistrimin e kafshëve blegtorale si dhe regjistrimin e qenve me pronar. Po ashtu do të bëhet kontrolli i subjekteve që merren me importin dhe shpërndarjen e PMV me qëllim të mbikëqyrjes

së shitjes së barnave veterinare. Gjithashtu do të bëhet kontrolli i fabrikave të ushqimit të kafshëve.

Në objektivin e tretë mbrojtja e shëndetit të bimëve duke u bazuar në ligjin për Mbrojtjen e bimëve Nr. 04/L-120, Sektori fitosanitar për vitin 2023 do të vazhdojë me aktivitetet të cilat kanë për qëllim mbajtjen nën kontroll të shëndetit të bimëve duke bërë zbatimin e bazës ligjore në fuqi në të cilën përcaktohen përgjegjësit të cilat ndërlidhen me ndërmarrjen e masave parandaluese që kanë për qëllim ndalimin e shfaqjes dhe përhapjes së dëmtuesve karantinor për bimët dhe produktet bimore.

I. Hyrje

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ka hartuar Planin e Performancës, duke u bazuar në Rregulloren (QKR) nr.03/2020 për Performancën e Agjencive, e cila derivon nga Ligji Nr. 06/1-133 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Përmes Planit të Performancës, AUV paraqet vizionin për progres në veprimtarinë e saj, me qëllim të përmirësimit të sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve.

Plani i Performancës së AUV, ndërlidhet me objektivat e punës së Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të harmonizuara me Planin Kombëtar për Zhvillim 2023-2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës- PKZH.

Për të ngritur performancën e AUV, janë planifikuar tri objektiva, të cilat konsiderohen të domosdoshme, të ndarë në dy pjesë, *pjesa përshkruese dhe pjesa tabelore*, të hartuar në koordinim me MBPZHR dhe Sekretariatën Koordinuese të Qeverisë (SKQ).

II. Përmbledhje e Objektivave

Objektivat e Planit të performancës së AUV-së janë:

1. Mbrojtja e shëndetit publik;
2. Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve;
3. Mbrojtja e shëndetit të bimëve

1. Mbrojtja e shëndetit publik

Bazuar në Ligjin për Ushqimin Nr. 08/L-120 e Ligjin e Veterinës Nr. 21/2004 dhe aktet nënligjore në fuqi, Drejtoria e Shëndetit Publik edhe gjatë vitit 2023 do të vazhdon me trajtimin e problematikes së mbrojtjes së shëndetit publik, sigurisë ushqimore, mbetjeve në ushqim dhe nënprodukteve shtazore në nivel vendi. Do të bëhet koordinimi i punëve me sektorët e Drejtorisë së Inspektoratit dhe sektorëve të Drejtorisë së Shëndetit Publik - Sektorit të higjienës së ushqimeve me prejardhje shtazore, Sektorit të higjienës së ushqimeve me prejardhje jo shtazore, Sektorit të nënprodukteve shtazore dhe Sektorit të mbetjeve në ushqim, në hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Vjetor Kombëtar të Kontrollëve Zyrtare dhe Mostrimit - PVKKZM 2023;

Gjithashtu do vazhdohet me regjistrimin dhe aprovimin e bizneseve me ushqim dhe operatorëve të bizneseve me nënprodukteve shtazore, do përditësohen listat dhe do publikohen në Ueb Faqen e AUV-it.

Me qëllim të realizimit sa më efektiv të këtij plani do të zhvillohen edhe aktivitete si më poshtë:

- ✓ Hartimi i "Planit Vjetor Kombëtar të Kontrollëve Zyrtare dhe Mostrimit - PVKKZM";

- ✓ Monitorimi i zbatimit të "Plani Vjetor Kombëtar të Kontrollleve Zyrtare dhe Mostrimit - PVKKZM " ku përfshihet edhe monitorimi i prezencës së mbetjeve në produktet ushqimore;
- ✓ Regjistrimi dhe aprovimi i operatorëve të bizneseve me ushqim;
- ✓ Regjistrimi dhe aprovimi/licencimi i operatorëve të bizneseve me nënprodukte shtazore;

2. Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve

Duke u bazuar në Ligjin e Veterinës Nr. 21/2004 dhe Ligjin mbi Përkujdesen ndaj kafshëve Nr. 02/L-10 dhe aktet nën ligjore në fuqi, Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies së kafshëve edhe gjatë vitit 2023 do të vazhdojë me trajtimin e problematikave sa i përket shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve në nivel vendi. Duke u nisur nga situata në terren, DSHMK do të bëjë koordinimin e punëve së bashku me inspektoratin veterinar të AUV-së në mënyrë që të realizohen planet e kontrolleve zyrtare të sektorëve të drejtorisë respektivisht Sektorit të Shëndetit të kafshëve, Sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve, Sektorit të Mirëqenies së kafshëve dhe Sektorit të Produkteve Mjekësore veterinare.

Me këtë plan parashihet kontrolli i subjekteve veterinare dhe fermave blegtorale me qëllim të monitorimit mbi aplikimin e barnave veterinare, lajmërimin e sëmundjeve, përkujdesen ndaj kafshëve, identifikimin, regjistrimin e kafshëve blegtorale si dhe regjistrimin e qenve me pronar. Po ashtu do të bëhet kontrolli i subjekteve që merren me importin dhe shpërndarjen e PMV me qëllim të mbikëqyrjes së shitjes së barnave veterinare. Gjithashtu do të bëhet kontrolli i fabrikave të ushqimit të kafshëve.

Me qëllim të realizimit sa më efektiv të këtij plani do të zhvillohen edhe aktivitete si më poshtë:

- ✓ Hartimi "Plani Vjetor të Monitorimit dhe Kontrollit të sëmundjeve të kafshëve "
- ✓ Përcjellja e situatës Epizootologjike në lidhje me prezencën e sëmundjeve të kafshëve duke u bazuar në informatat nga terreni dhe raportet e

Organizata Ndërkombëtare për shëndetin e kafshëve - WOAH-së dhe sistemi i lajmërimit të sëmundjeve i KE - ADIS

- ✓ Marrja e mostrave të kafshëve për hulumtime diagnostike dhe kryerja e analizave në sëmundjet e kafshëve
- ✓ Zbatimi i Plani Vjetor të kontrolleve zyrtare nga inspektorati I AUV-së
- ✓ Identifikimi, regjistrimi dhe përcjellja e lëvizjes së kafshëve

3. Mbrojtja e shëndetit të bimëve

Bazuar në ligjin baze për Mbrojtjen e bimëve Nr. 04/L-120, Sektori fitosanitar për vitin 2023 do të vazhdojë me aktivitetet të cilat kanë për qëllim mbajtjen nën kontroll të shëndetit të bimëve duke bërë implementimin e bazës ligjore në fuqi në të cilën përcaktohen përgjegjësit të cilat ndërlidhen me ndërmarrjen e masave preventive që kanë për qëllim ndalimin e shfaqjes dhe përhapjes së dëmtuesve karantinor për bimët dhe produktet bimore.

Tanimë është hartuar drafti i planit të monitorimit të dëmtuesve me prioritet të lartë për pemët dhe perimet dhe dëmtuesve me status karantinor i cili do të jep si aktivitet me prioritet të lartë i cili do të arrihet përmes monitorimit dhe i mbështetur nga GIZI me pajisjet e nevojshme që kërkohen për këtë qëllim.

Ndikimi buxhetor

Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, AUV-së i ka ndarë buxhet në shumë prej 724,000.00€ në kategorinë *Investimeve kapitale* dhe 3,147,146.00€ për kategorinë *Mallra dhe Shërbime*.

Nga mjetet e ndara për Investime kapitale, u planifikua Ligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, AUV-së i ka ndarë buxhet në shumë prej 724,000.00€ në kategorinë *Investimeve kapitale* dhe 3,147,146.00€ për kategorinë *Mallra dhe Shërbime*.

Nga mjetet e ndara për Investime kapitale, u planifikua :

Pajisje e Laboratorit veterinar dhe ushqimit si dhe laboratorit nacional të gripit të shpezëve 250,000.00

Blerja e veturave speciale për mostrim 50,000.00

Furnizim me pajisje të TI-së 100,000.00

Fabrikës së Riciklimit (IPA) 100,000.00

Ndërtimi i zyrës regionale për Inspektoratin e AUV-së në Ferizaj 62,000.00

Ndërtimi i zyrës regionale për Inspektoratin e AUV-së në Gjakovë 62,000.00

Blerja e veturave speciale për Inspektoratin e AUV-së 100,000.00

Për të realizuar Planin e Performanca, AUV nga mjetet e ndara në kategorinë e Mallra dhe Shërbime, për secilën Drejtori ka planifikuar buxhete si në vijim:

Furnizimi I LUV me material shpenzues	245,664.00
Mbrojtja e shëndetit publik të kafshëve me anë të vaksinimeve	563,803.00
Mbrojtja e shëndetit publik të kafshëve me anë të hulumtimeve diagnostike	174,770.00
Siguria e Ushqimit	55,274.40
Identifikimi dhe regjistrimi I kafshëve	675,000.00
Inspektimet(analizat laboratorike)	92,124.00
Mirëqenia e kafshëve dhe kontrolli I qeneve endacak	87,210.72
Blerja e pajisjeve për Inspektorë	113,793.25
Parandalimi dhe trajtimi I Etheve hemorragjike	286,722.39
Fabrika e riciklimit	190,958.90
Kontrolli I qeneve endacak	201,000.00
M&SH(për të gjitha shpenzimet e tjera)	460,816.80
TOTALI I APROVUAR PËR VITIN 2023	3,147,137.46

PJESA TABELORE E PLANIT TË PUNËS


Nr.	Objektivat 1. Mbrojtja e shëndetit publik					Vlera bazë	Caku
1.	Zbatimi i planit të kontrolleve zyrtare					2023	
2.	Treguesi i Performances: Renovimi i ndërtesës së Arkivit Shtetëror të Kosovës						
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimet financiare	Produkti	
1.1	Hartimi i planit vjetor kombëtar të kontrolleve zyrtare dhe mostrimeve - PVKKZM	Drejtoria e Shëndetit Publik	K1 - K4	55,000.00	Buxheti i Kosovës	Plani i aprovuar nga DE	
1.2	Aprovimi dhe regjistrimi I operatorëve të biznesit me ushqim	Drejtoria e Shëndetit Publik	K1 - K4	25,000.00	Buxheti i Kosovës	Evidentimi i operatorëve që merren me ushqim	
1.3	Zbatimi I PVKKZM nga inspektorati I AUV-së	Drejtoria e Shëndetit Publik	K1 - K4	145,000.00	Buxheti i Kosovës	Realizimi sistematik i kontrolleve zyrtare	
1.4	Licencimi/aprovimi dhe regjistrimi I subjekteve që merren me nënprodukte shtazore	Drejtoria e Shëndetit Publik	K1-K4	190,000.00	Buxheti i Kosovës	Evidentimi i operatorëve që merren me nënprodukte shtazore	
	Buxheti i aprovuar për objektivin 1.			415,000.00 €			
Nr.	Objektiva 2. Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve					Vlera bazë	Caku
1.	Treguesi i performances: Gjurmueshmëria e sëmundjeve të kafshëve					2023	
2.						2023	
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti	
1.1	Hartimi "Plani Vjetor të Monitorimit dhe Kontrollit të sëmundjeve të kafshëve "	Shëndeti dhe Mirëqenia e Kafshëve	K1		Buxheti i Kosovës	Plani I aprovuar nga DE	

1.2	Përcjellja e situatës Epizootologjike në lidhje me prezencën e sëmundjeve të kafshëve duke u bazuar në informatat nga terreni dhe raportet e WOAH-së dhe ADIS	Shëndeti dhe Mirëqenia e Kafshëve	K1 - K4		Buxheti I Kosovës	Marrja e masave në parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive
1.3	Marrja e mostrave të kafshëve për hulumtime diagnostike dhe kryerja e analizave në sëmundjet e kafshëve	Shëndeti dhe Mirëqenia e Kafshëve; Laboratori I Ushqimit dhe Veterinarisë	K1- K4	1,300,000.00	Buxheti I Kosovës	Numri mostrave të marra me qëllim të monitorimit të sëmundjeve të kafshëve
1.4	Zbatimi I Planit Vjetor të kontrolleve zyrtare nga inspektorati I AUV-së	Inspektorati	K1- K4	470,000.00	Buxheti I Kosovës	Kontrolli dhe parandalimi i sëmundjeve të kafshëve
1.5	Identifikimi, regjistrimi dhe përcjellja e lëvizjes së kafshëve	Shëndeti dhe Mirëqenia e Kafshëve	K1- K4	675,000.00	Buxheti I Kosovës	Raportimet e të gjitha kafshëve në data bazën e sektorit I&R
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:			2,445,000.00 €		
Nr.	Objektiva 3. Mbrojtja e shëndetit të bimëve				Vlera bazë (baseline)	Caku

1.	Treguesi i performances: Gjurmueshmëria e sëmundjeve të bimëve				2023	Aktet nënligjore të Aprovuara
2.						
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria Përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti (Output)
1.1	Hartimi "Plani Vjetor të Monitorimit dhe Kontrollit të dëmtuesve me prioritet për bimët dhe produktet bimore "	Drejtoria e Inspektoratit	K1 - K4		Buxheti i Kosovës	Përfshirja e të gjithë operatorëve që merren me kultivimin e bimëve dhe grumbullimin e produkteve bimore
1.2	Monitorimi I organizmave me prioritet të larte bazuar ne protokollet dhe		K1-K4	40,000.00	Buxheti i Kosovës	Inventarizimi I dëmtuesve me prioritet të larte për bimët dhe produktet bimore

	udhëzuesit për monitorim ne zbatim te planit vjetor te monitorimit .	Drejtoria e Inspektoratit					
1.3	Marrja e mostrave te bimëve dhe produkteve bimore për identifikimin sëmundjeve dhe dëmtuesve	Drejtoria e Inspektoratit	K1-K4	52,000.00	Buxheti i Kosovës	Pasqyra e gjendjes sa I përket pranisë se dëmtuesve dhe sëmundjeve te bimëve	
1.4	Ndërmarrja e masave fito sanitare komfor te gjeturave nga monitorimi dhe bazuar nga rezultatet e analizave laboratorike	Drejtoria e Inspektoratit	K1-K4		Buxheti i Kosovës	Zbatimi I masave fito sanitare me qellim te ndalimit te përhapjes se sëmundjeve dhe dëmtuesve	
	Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3:			92,000.00 €			

Flamur Kadriu, Zv. Drejtor Ekzekutiv
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë




Faton Peci, Ministër
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



Data: 30.12.2022

Faqe 10 nga 10